

Michael D. Higgins - Poezi - Stinë e thatë



**MICHAEL D. HIGGINS**  
**STINË E THATË**

Michael D. Higgins - Poezi - Stinë e thatë

Michael D. Higgins - Poezi - Stinë e thatë

**MICHAEL D. HIGGINS**

**STINË E THATË**

p o e z i

**PËRKTHEU: NDREK GJINI**

  
*Klubi i Poezisë*  
Tiranë

Tiranë, 2021

Michael D. Higgins - Poezi - Stinë e thatë

Libri Stinë e thatë është botuar për herë të parë në vitin 2004 nga Shtëpia Botuese New Island në Dublin, Irlandë.

Titulli: Stinë e thatë  
Autori: Michael D. Higgins  
Përktheu: Ndrek Gjini

© Klubi i Poezisë, Tiranë

ISBN

Tiranë, 2021

## **Poeti President i Irlandës**

Poeti Michael D. Higgins (1941) është President i Irlandës që nga Nëntori i vitit 2011.

Në vitin 2018 u rizgjedh për një mandat të dytë shtatëvjeçar në këtë post, për deri në vitin 2025.

Ai arriti të marrë numrin më të madh të votave si person në historinë e Republikës së Irlandës.

Higgins ka një karrierë të gjatë si politikan.

Ai është poet, sociolog, aktivist i të drejtave të njeriut, profesor në universitet etj. Ka udhëhequr Partinë Laburiste të Irlandës për shumë e shumë vite. Ka qenë Ministër Kulture për disa vite. Deputet pa ndërprerje që në vitet 1980. Ai, pavarësisht gjithë këtyre posteve gjithnjë ka jetuar në qytetin ku u rrit dhe u shkollua: në Galway. Kjo deri në ditën kur mori postin e Presidentit të Republikës dhe ligji e detyronte të jetonte në pallatin presidencial në Dublin.

Higgins njihet ndër të tjera edhe si dashamirës i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai besohet se është zyrtari i lartë, i vetëm në Evropë, që ka takuar më shumë shqiptarë dhe ka diskutuar me ta për hallet dhe shqetësimet që kanë. Mbrojtja që Higgins i ka bërë në Parlamentin Irlandez shoqatës humanitare “Irish Friends of Albania” (Miq të Irlandezë të Shqipërisë), dhe pjesmarrja e tij në takimet vjetore të kësaj shoqate, është fakti me mbreslënës për këtë përkrahje dhe përkujdesje të tij ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve.

*Ndrek Gjini*

Ky libër poetik, si letra miqësie e dashurie të poetit President të Irlandës, Michael D. Higgins, u shtyp në gjuhën shqipe falë mbështetjes financiare të sipërmarrësit të njohur humanist z. Flamur Hoxha të cilin, si Shtëpi botuese e promovuese, e falenderojmë përzemërsisht.

## **Pluhur yjor**

Ne jemi pluhur yjor  
i formuar prej avujsh dhe grimcash  
nga krijimi dhe shuarja e galaksive.  
Ne jemi ato thërmijat e vockla të kozmosit tonë  
ikur nga mbetjet e shtratit të memories  
vjedhurazi,  
duke ecur gjithmonë në drejtim të imazhit tonë,  
të shpresave të porealizuara,  
dhe duke u venitur.  
Premtimi për përsosjen tonë akoma të  
porealizuar ekziston ende  
megjithëse i vakët.

Në këtë lëvizje ne e gjejmë shpëtimin  
brenda qelizës së arsyes.  
Prej këtij lloj burgu  
dëgjohet vajtimi ynë  
ç'ka tregon se ne nuk jemi veç fëmijët e arsyes.

Shikimin kemi hedhur nga trojet e shpirtit.  
Trubullirat e së tashmes janë tërhequr.  
Mish-mashi i gjërave që janë përtej  
kohës dhe hapsirës jehon.

Dyshimi na fton në një udhëtim  
për të dalë kundër sigurive të rreme  
të bëra me punë të pakta dhe metoda primitive.

Një predikim të përvajshëm  
do të mbajnë fjalët tona të dëbuara  
si ushtima të një profecie të humbur.  
Thellë brenda vetes e dëgjojmë atë thirrje  
që na dhuron më shumë se ngushëllim  
duke krijuar një histori të re të një kohe të re  
dhe hapsire të mrekulleshme.  
Premtim i një lumturie ende të palindur  
krijuar nga pluhuri yjor.



## **Një stinë e thatë**

Po vjen një errësirë  
e cila s'e mbart apak vlagën  
e ndonjë shenjë drite.  
Është një errësirë e thatë që kërcënon,  
Errësirë e një kohe shkretëtirë.

Mungojnë fjalët e mjaftueshme  
për të ndezur zjarrin e shqisave.

Ka pllakosur një heshtje  
që bujarisht terrin e mirëpret  
atje ku hijet e gjërave të së shkuarës  
fluturojnë njëra pas tjetrës  
duke trembur kujtesën  
që gati sa s'po i ndalet fryma  
në këtë kohë të pjetë.

Dhe nga brendësia e kësaj kohe pa ajër  
një ofshamë gjigande del

nga përballimi i madh.  
Është ofshama e dhimbjes së një fillimi të ri  
për fjalën  
për dashurinë  
për shpresën.

Kur qetësia thyhet,  
britmat dhe lutjet nën zë  
drejtuar një Perëndie,  
që hesht si lis i thatë,  
mbushin ajrin.  
Në këtë ajër të thatë  
pa përgjigje mbeten këto britma dhe lutje.

Dhe në këtë kohë të paimagjinueshme  
kur planetet vdesin  
nuk do të ketë më gjurmë  
të kohës së vjetër të fjalëve.  
Gjithçka do të jetë rikthyer në pluhur  
prej nga dhe ishte krijuar.

Në këto momente gjysmëdrite  
ne duhet të mos kemi frikë të derdhim lotë  
për errësirën që po vjen.

Dhe nga vloga e këtyre lotëve  
do të shpërthejë një ndriçim i fortë i shqisave  
me të cilat ne mundemi të ëndërrojmë  
për hapsirën e përbashkët njerzore që ndamë  
në kohën që na u dha për ta jetuar.

Në këtë muzg do të ndodhë që të pafrymët

do të kërkojnë njëri-tjetrin  
duke vajtuar për fjalët e humbura të dashurisë,  
që s'arritën të thuhen në kohën e ndërrimit të  
stinëve.

Duke krijuar një trishtim të thellë  
në këtë errësirë të pashpresë.

Por në këtë gjysmëdritë le të këndojmë,  
të gëzojmë  
dhe të qajmë gjithashtu me ndershmëri  
për ato fjalë të humbura që nuk u thanë,  
për dashuritë e pafat,  
për duart e thata  
që s'u shtërnguan e s'u puthën.

Në mes stinëve po presim.  
Kohë e thatë po na fton  
dhe bukuria e gjërave të thjeshta  
bëhet e çmuar.  
Lulet nuk çelin  
për sa kohë që ne me habi vështrojmë bimet e  
këqija.

Sepse në rrënjët e këtyre bimëve tani të  
vlerësuara  
në këtë pritje tonën midis stinëve  
nuk ka veç pluhur  
por dhe ca fara mjaft të bukura  
të shpërndara në këtë shtresë të hollë të dheut  
fara të shpresës e cila mund të mbijetojë  
edhe në kohën pa ajër.

Dhe askush nuk e di  
nëse në hapsirën pafund  
do të flitet ndonjëherë  
apo dhe as të kujtohet  
fakti që ne u përpoqëm të bëjmë një histori  
me arsye arrogante  
në një kohë normale.

Në fund të fundit  
ne jemi të etur për shpresë  
dhe për një vendbanim të ri  
për frymën e shpirtit.

Sepse në vendbanimin e shpirtit  
një jetë e re mund rilindë përsëri  
me rregulla të reja loje  
për mendjet dhe fjalët.  
Kjo është lutja jonë  
në këtë prag errësire.

Nuk është zbrazëtia  
ajo që pret  
përtej errësirës  
por hapsira e dashurisë së përjetshme.

Lutja jonë e fundit  
është thënë  
brenda kësaj  
heshtje të mirëpritur.

## **Në fillim 1**

Në fillim qe Fjala  
por Fjala nuk qe fillimi.  
Kur nën ndikimin e rregullave  
që u vendosën në kohë të dhunshme  
drita u venit  
grimcat që u shpërndanë në errësirë  
nuk u vetëorganizuan ndryshe  
veçse në formën e mosarsyes.

Nuk qe fillimi pa rregulla  
dhe as fjala ajo që kërkoi rregulla në fillim.  
Fjala qe në formën e mosarsyes  
përtej vështrimit dhe frymëmarrjes.  
Ishte një errësirë e thellë dhe rrëmujë e plotë  
kur Fjala erdhi.

Ajo klithma e parë për ndihmë  
është fillimi  
i një nënshtrimi të gjatë  
i cili nuk krijohet lehtësisht.  
Lufta për të rigjetur heshtjën  
do të jetë e pambarim.  
Vështrimi që i parapriu fjalës  
si fantazëm do shfaqet.  
Fryma që e ndërmjetësoi

herë pas herë do lëshojë  
një klithmë pikëllimi apo dashurie.

Dhe, nëse ne me dobësinë tonë  
i ledhatojmë fjalët e pagdhendura  
të ardhura nga kreshtat e thepisura të kohëve të  
gurta  
e i bëjmë rruzare për lutjet tona  
ose muzgut të ngopur të një të Diele i ulërijmë,  
atëherë shpirtrat tanë nuk i këndojnë  
venitjes së dritës  
dhe as valëve të detit larguar nga bregu.

Fytyra e lodhur  
është e mbushur me lotë.  
Jo të bardhë  
por të zi,  
ne e kërkojmë  
një zë nga errësira  
e paralindjes së Fjalës  
dhe premtimin e rremë të qetësisë.

Kripa e lotëve  
është arka e kujtesës  
së fillesave tona detare.  
Aty ruhet  
psherëtima e thellë  
e gjithë kohës sonë  
të humbur në hapsirën e pafund.

## **Në fillim 2**

Fryma dhe mushkëritë komplotojnë  
kundër heshtjes së shpirtit  
në interes të mbretërimit të zërit.

Nuk janë vetem fjalët.  
Çdo rrokje është  
një formë e mëjtejshme rrokullisje  
larguar nga hapsira e frymëmarrjes  
që ndërmjetëson për një moment  
para se të dorëzohet  
tek goja e hapur e dhimbjes fillestare  
nën vështrimin e rreptë të rregullit.

Dhe fjalët rendin pas njëra-tjeterës  
pandalim në udhëtimin e tyre të gjatë  
drejt një rrugëdalje  
të padëshiruar dhe plot pengesa.

Të dënuar jemi të lexojmë

kujtimin e gjërave të perealizuara.  
Shumë shpesh ndjejmë brerje në ndërgjegje.  
Ato gjëra të perealizuara na shkatërrojnë  
dhe e bëjnë të paaftë krejt gjeneratën  
në ndjesitë e reja aq të nevojshme  
që janë brumi i fillimit të ri.

Ato momente të humbura kristalizuar  
brenda memories  
janë një verejtje  
e cila vazhdimisht iu bëhet  
përjetimeve të së tashmes  
duke krijuar një listë strikte  
pyetjesh,  
qortimesh  
për ndjesitë e humbura.

Pse ne nuk pamë nga yjet bashkë  
dhe të hidhëroheshim  
qanim hallet e këndonim  
apo këtu nën hënë  
në ujë të hidheshim së bashku.

Kurrë nuk mund të mohohet fakti  
që ne nuk kemi qenë të informuar  
rreth asaj që thelbi çka trashëgohet  
është formuar  
nga mënyra se si është parë rregulli.

Do vdesim, na është thënë,



të mbyllur brenda ca gjërave të sigurta  
jo nga ato që kemi ndërtuar vetë,  
do biem në heshtjen e trishtuar  
rrethuar veç nga vetvetja.

Duke kërkuar magjinë e së ardhmes  
ne krijojmë një këngë  
kushtuar mërgimit  
në burgun e vetvetes.

Marrim frymë përsëri dhe pohojmë  
se asgjë s'është e pashmangshme.  
Stërmundimi ynë  
nuk është thjeshtë iluzion.  
Krijimi i një bote të re po jep sinjalet e saj.

Drita që ndriçon përsëri  
errësirën kaotike të fjalëve të humbura  
premtion shërim  
është ftesë drejt një ngrehine  
e një vendi të ri të përbashkët  
të qetë  
ku nuk kërcënon asgjë.

## **Në pyll 1**

Duke ecur nëpër pyll  
kaloj përmes gjurmësh  
të krijuara nga udhëtarë këmbëzbathur  
apo të veshur me sandale.

Ka këtu, në këto gjurmë  
shëtitje murgjërish,  
ekskursione të mendjes dhe shpirtit  
Që pasi kanë qëndruar pezull, janë shpërndarë  
nga një mrekulli e re, e papritur  
në një vend tjetër të çuditshëm,  
të cilin kurioziteti e ka bërë të tyrin.

Këtu shqisat bashkohen.  
Ata nuk debatojnë  
për pjesët përbërëse të myshkut.  
Veç bëhen gati për të dëgjuar  
pyetjet që vijnë nga pylli.

Në këto momente kërcënuese dyshimesh  
kur frika kumbon  
përtej ndjenjës së heshtjes,  
mendimi për dritën e humbur  
djersë të ftohta sjell,  
dhe etiketon këtë hapsirë  
nën këto hije  
të rritjes së munguar.

Spërdredhje të dështuara  
rritjesh gjysmake  
dalohen kudo,  
duke u nisur nga trungjet  
e deri tek lëvoret e kalbura.

Gjethet nën këmbë  
gjysëm të kalbura  
kanë krijuar një si batanije  
prej plehu të murrmë.

Por, nëse në kohë të tjera  
pyetja na vjen nga një zemër e hapur,  
ajo është drita e pamposhtur  
nga rritja e madhe e disa stinëve  
që mbizotëron.

Dhe shqisat përherë festojnë  
në kujtim të asaj hapsire dritëplotë  
dhe dëshirës së fshehtë të heroit.

Pra njerzit kurrë më nuk do të largohen  
nga çadra e pasionit  
krijuar me aq shumë dëshirë e mjeshri.

Vizita në një vend të lagësht kërkon guxim.  
Mund të ketë të papritura.  
Përtej zgripit së kujteses së hapsirës,  
dhe para mësimeve  
që na vijnë prej ndonjë përralle,  
mbizotëron dëshira për t'u gjunjëzuar e lutur.  
Por edhe në këtë gjunjëzim,  
nisur nga pasioni dhe nevoja  
një forcë magnetike të shpie drejt rrezikut,  
në formën e një lufte të pambarim.

Por nëse shikimi mbahet lart  
drita bën mrekuulli  
me shkëlqimin e saj vezullues.  
Rrezet e dritës pikojnë bukuri,  
dhe përgjithnjë i zhdukin  
tërë format e hijeve dhe frikave.

Nga ky burim ngrohtësie  
i krijimit të jetës  
hedh hapat drejt dritës vezulluese  
të një normaliteti të sigurtë.

## **Në pyll 2**

Po kthehem nga pylli  
ngarkuar me kujtesën e gurëve  
dhe diellit vezullues.  
Eci bashkë  
Me të gjithë lëvoret e drunjëve  
dhe degët e tyre të spërdredhura.

Unë nuk pyes dot  
a është mendja në rregull,  
përderisa gjymtyrët  
lëvizin lirshëm  
dhe ndjehen të relaksuara  
e me një freski që dallohet lehtësisht.

Këtë pastrim  
nuk e shkakton errësira  
por drita vezulluese e kësaj dite  
ku trupi pa shenja plagësh  
rrezaton freski,  
dhe gjymtyrët forcohen,  
bëjnë deklarata fëmijnore  
duke i harruar thyerjet  
që kanë ndodhur kohë më parë.

Kam vendosur t'i ruaj këto gjurmë,  
këto shenja këmbësh të baltosura

që s'treten dot aq lehtë,  
pasi ato janë thirrja ime  
për të mos harruar,  
janë thirrja e memorjes sime.

Në memorje na mbetet  
diçka më shumë se pylli  
diçka më shumë se zhurma e gurëzve  
poshtë këmbëve tona  
diçka më shumë se pemët e bukura  
përçark një kishe fshati.

Ndjenjat e shpirtit  
e ndriçojnë errësirën e shenjtë  
përmes mërmërimave,  
që janë të mbushura plot  
me erëra, pluhur dhe djersë.  
Ato me një kioske druri  
plot kujtime të magjishme.

Hapsirë, ajër i pastër  
dielli shndrit fort por nuk na verbon  
gjithçka shkëlqen.  
Për një moment zemra nis vallzon përsëri.  
Nuk është trillim i mendjes  
as krijim i ndonjë fantazie fëminore.  
Ky vrull shpirti  
krijon magjinë e ngjalljes së shpresës.

## **Kujtesa**

“Dhe siç ka thënë Ricouer,  
të vrasësh kujtesën  
do të thotë të vdesësh për së dyti”.

Pra kurrë nuk duhet lejuar  
që dhuna të harrohet.  
Aministia mjafton  
vetem si një akt i shkruar.  
Dhe kush e di  
nëse ajo është bërë në kohën e duhur,  
apo nëse mund të sjellë ndonjë shërim,  
në mos qoftë krejt veç si një mbrëmje faljeje  
që thjeshtë ia vlen ta mbash.

Ne veç pohojmë.  
Shpresa na mban gjallë.  
Duke ikur prej errësirës  
një dritë të re shpërndajmë.

**Nëna ime u martua me tim atë në malin  
Melleray në 1937**

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

Ato fotografi ishin më të çmuarat  
e asaj kohe.  
Ajo në një profil anash  
Në pamjen më të bukur të saj.  
Ai i ri, i pashëm, stoik  
fytyrë e një burri të fortë, thonin.  
Ajo kishte veshur një pallto lëkure  
për rrugë  
dhe ai një xhaketë si gri në blu të lehtë  
dhe në jakë të saj kishte një simbol  
qe ia kishte dhënë si dhuratë  
bashkë me shumë bekime  
murgu që kreu ceremoninë.

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

Përse ne nuk duhet te qajmë  
për të lënë ca shenja kripe  
për të tjerë lotë



që e dinë se çfarë është pikëllimi.  
Dhe të kërkojmë të gjejmë  
një ofshamë të thellë  
që del prej një frymëmarrje drithëruese  
nga thellësia e shpirtit,  
dhe dridhet si në ethe  
në kërkimin të së vërtetës.

Historitë e padrejtësive  
dhe humbjet e dhimbshme  
të shumë njerzve  
na sugjerojnë të mos derdhim kurrë  
lotë të cilët nuk dalin  
nga thellësia e zemrës,

lotë që janë larg nga burimi  
i një plage të thellë  
që rrjedh si një psherëtimë e gjatë  
përmes një frymëmarrje të mekur.

Unë qaj atë fëmijë të humbur  
që koha e detyroi  
të bëhej burrë para kohe  
dhe të mos shijojë gëzimin e sinqertë,  
as buzëqeshje,  
veç fjalë të ashpra.

Janë këto gjëra të vogla  
që në të vërtetë të bëjnë të dridhesh  
për këtë vijimësi padrejtësish  
që memorja jonë detyrohet t'i mbartë.

Ato janë aty dhe shpërthejnë herë pas here.

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

Mbështetur në anë të një guri mulliri  
babai im u largua përsëri.  
Një plak i vjetër  
më tregon se ai do të ecte vetem për nja një milje  
deri tek autobusi  
i cili do të ndalonte  
para një parcele me grumbuj lakrash të thara,  
dhe ca sfurkëve e rrashqelave të pastra,  
vend që ai e njhte mirë.  
Kthejmë kokat e shihemi në sy,  
një rreze e zbehte shprese  
më bën të besoj se ai është i fortë  
dhe do iu mbijetojë dallgëve të jetës.  
Ai hoqi nga jaka e ngrohtë e xhaketës së tij  
atë simbol që ia kishin vënë aty  
që ditën kur qe martuar.

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

Ai ishte një simbol i stilit të vjetër  
i krijuar për ikje  
dhe ankorimi jo të përkohshëm  
një imazh i smaltuar  
i një kryqi dhe i një dore  
lyer kuq dhe jeshil.

Tani shenjën e bashkëshortësisë  
në të nuk mund ta dalloj askund.  
Nuk e dalloj dot në të  
atë lidhje të fortë intime  
të pathyeshme  
që kishte emigruar  
së bashku me të  
dhe me deshprimin e tij.

Ka kaluar shumë kohë  
nga jaka e asaj xhakete  
që në atë kohë i përkiste  
një mode të avancuar  
dhe ishte zgjedhur për t'u veshur  
në ditë të shënuar,  
deri tek ajo pallto e famshme  
e një intimiteti të harruar  
që tani vishet për të të mbajtur ngrohtë  
kur ai bën ndonjë vizitë të rrallë.  
Tek ne fëmijët e tij  
Ai tashmë është një gjysmë i humbur  
E krahët e asaj xhakete lëkure  
veç sjellin në memorje  
aftësitë e atij mjeshtri  
të talentuar që e ka qepur,  
dhe krenarinë e tim eti  
që e ka veshur atë.

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

Nuk ka asnjë para  
dhe asgjë tjetër për të dhënë.  
Ai e heq atë simbol të çmuar  
nga palltoja e tij,  
atë simbol të cilin  
sytë e mi e shikonin me lakmi  
e më bënë më të afërt me të.  
Ai e heq atë simbol  
e mua ma zgjat si dhuratë  
me atë dorën e tij  
që unë kurrë s'e kisha puthur.  
Unë e mora atë  
por e humba kur unë vetë emigrova.  
Kur e kujtoj tani  
këtë dhuratë të vogël  
por të shenjtë  
ndjej dhimbje për fatin e tij,  
për sakrificat e tij,  
dhe për fëmijërinë time  
të munguar.

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

E ruajta këtë dhuratë të shenjtë  
Dhënë nga babai  
Në një vend që veç ne e dinim.  
Në këtë botë  
ku jeta është e shkurtër  
përse nuk lejohen kujtimet?

Përse na kërkohet t'i harrojmë  
këto momente të vogla por të shenjta,  
këto gjëra të rralla por të çmuara për ne  
nga ato vite kur koha ishte një ajsberg  
dhe shumë gjëra ishin të ndaluara.  
Përse pra na kërkohet t'i harrojmë  
këto ndodhi të vogla, mbushur plot lotë  
dhe dashuri?

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937.*

Edhe pse pikëllohem,  
shërimi prapë është i pasigurtë.

Sepse krejt besimi  
është besim i brishtë  
por këto gjëra të vogla  
delikate, mund të mbijetojnë  
e të shpërfaqen  
në këtë hapsirë drithëruese  
plot mbresa.

Ato krijojnë ca ndjeshmëri, ca kufinj  
që i mundësojnë kujtesës  
të bëjë mrekullira.

*Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray  
në 1937*

## **Pusi 1**

Nuk është pusi i rrethuar nga shume njerëz  
që më shfaqet në kujtesë,  
por është ai pus i cili nuk shterroi  
gjatë asaj stine të thatë,  
duke sfiduar dyshimet tona  
për një katastrofë të afërt thatësire  
ku bagëtitë mund të ngordhnin  
në këtë stinë të thatë.

Toka u tha, u pjek, u plasarit  
Nga një diell që zhurit anë e mbanë.  
Në zemrën e lagur të pusit  
balta e humbi betejën  
dhe uji i pastër, triumfues  
deklaroi fitoren e fundit.

Kjo është një provë e fortë mbijetese  
në pritjen plot durim  
të shfaqjes së një rrjedhe të re  
nga ndonje kapilar uji  
që vjen prej thellësive të tokës  
që ne nuk i shohim.

Dhe del në sipërfaqe  
duke shpallur madhërisht  
mbijetesën dhe triumfin  
mbi këtë stinë të thatë.

## **Pusi 2**

Ta vizitosh përsëri pusin e miqësisë,  
dhe të hedhësh në fund të tij një litar të vjetër  
me kovën e jetës së dikujt.  
Të dëgjosh zhurmën e kësaj kove  
tek prek muret e këtij pusi  
duke të risjellë emocione të forta  
të kohës së fëmijërisë  
përbën një pelegrinazh magjik.  
Ta tërheqësh sipër atë litar  
dhe të pish ujë nga ajo kovë  
duke shuar atë etje të ëmbël  
ngjan sikur kohën ke ndalur.  
Gjithçka e ripërtërin  
freskia e këtij uji që del  
nga fshehtësitë e tokës.  
Të shuajmë etjen me këtë ujë  
kufinj të kohës zhduken  
bashkë me çdo lloj dyshimi  
për vazhdimësinë e jetës.

## **Gomari**

Më kujtohet ajo lëvizja e veshëve të tij të butë  
ku, siç e kishte zakon ulte kokën  
dhe mbyllte sytë  
e dorëzohej kur i futnin  
frerët e metaltë në gojë  
mes dhëmbëve të tij të verdhë.

Dhe kryqi i vendosur mbi shpinë  
nuk i jepte atij ndonjë status të shenjtë,  
ai kryq është thjeshtë simbol mirënjohje  
për ngarkesën që mbart  
dhe madje nuk i garanton as mbathjen  
e thundrave të tij.

Koka e një gomari,  
gjiri i ngrohtë i një lope,  
turfullima arrogante e një kali,  
frymëmarrja e shpeshtuar e një qeni,  
kositja e bimëve të gjelbra,  
bluja e zbehtë a moçalit me kallamishte,



stërmundimi i ngjalave të ngecura në llucë,  
e shoqërojnë rrjedhën e uijt  
drejt një grykëderdhje të rrëpirtë.

Ç'është ajo forcë magjike  
që i bën këto peisazhe t'u mbijetojnë  
katastrofave të kohës,  
që ngadalsojnë rrënimin dhe shembjen  
e një shtëpie  
mbulesa prej kashte e së cilës  
është kalbur krejt, dhe ka rënë brenda?

Janë ndofta ato ndjenja intime  
të mbjella këtyre fushave si farë  
në kujtesën tonë.

Në ato raste të rralla  
kur ai e ndal galopimin  
unë para se t'i tërheq sërish frerët  
risjell në mendje të shkuarën,  
dhe kurrë nuk nxitoj ta rinis galopimin,  
e as nuk i klith me zë të lartë,  
pasi e rrespektoj lirinë e tij.

Shumë më shumë se këto pisazhe  
mua më kënaq shoqërimi me të  
dhe kujtimet e bukura të së shkuarës  
që më risjell në kujtesë.

## **Hapja e pakove**

Është bërë normale  
që në krye të fletës së çdo pakoje  
të ardhur nga jashte  
që hapet  
të shënohet një numër me bojë të zezë  
i cili në të vërtetë  
përbën zyrtarizimin  
e një vjedhje të licensuar  
të mundimeve të emigrantëve.

Këto pako shpërfaqin një magji  
me format e tyre të çuditshme.  
Brenda tyre qëndrojnë  
copëze ndjenjash e jetësh njerzore,  
me mbishkrime adresash  
të ca zonave që ne i njohim mirë  
e që janë mbresëlënëse  
dhe mjaft domethënëse  
në hapësirën ku ne jetojme.

Ato kanë një ndriçim të mistershëm;  
kanë në to ca vijëzime

gati mistike dhe kujtime  
lënë nga duart e atyre që kanë ikur.

Këto vijëzime dhe fjalë  
përcaktojnë domethënien  
e sendeve aty brenda  
të paketuara me aq kujdes  
e me shumë merak  
me mbështjellëse të bukur  
nga ato duar që bëjnë mrekullira,  
duar që malli i bën të dridhen  
nga kujtimet e fëmijërisë së largët.

Ajo dhuratë për të rritur  
e mbështjellë si për fëmijë  
që mezi po e presin,  
kurrë nuk ishte një objekt zbukurimi  
dhuruar në mënyrë sekrete  
nga ndonjë vend i panjohur.

Ka mbërritur  
e pakëtuar,  
dhe zbulimi i madh  
kur hapet kjo pako  
shpërfaq përherë  
një dhuratë të magjishme.

Dhuratat që mbërrijnë  
dhe që duhen shpërndarë,  
bëhën përkohësisht

pronë e disa përsoneve,  
të cilët duhet të gjykojnë  
se si t'i rigrupojnë  
në arka të ndryshme,  
mbushur me plot historira të çuditshme  
gjatë rrugës për këtu.

Në pritje  
të kthimit të emigrantëve.

Pas shpërndarjes  
së këtyre pakove  
sikur diçka brenda jush ka lëvizur.  
Diçka ka lëvizur mes nesh dhe jush  
mes dy vendeve,  
mes dy kohërave,  
të jetës sonë.  
Ikja dhe kthimi i juaj  
Janë shkrirë në një.  
Janë bashkuar në rrethin  
e emigrimit dhe kthimit tuaj.

Kur ju e paketuat dhe e mbyllet atë pako,  
ne e dinim, zemra jonë e ndjente  
se aty brenda nuk kishte si të futej  
krejt historia e mundimeve tuaja.  
Dhe pikërisht për këtë ne u jemi  
shumë mirënjohës.

## **Nokturn 1**

Pas asaj humbje të madhe,  
deshpërimi,  
si një dhimbje e fortë,  
ngjyrë gri,  
rri kyqur në stomak,  
dhe pandërprerë  
lëshon psherëtima të gjata.

Si një hije e errët  
brenda qënies sime  
është ky deshpërim.

Shpresa që mendimi krijon  
nuk ka fuqi ta largojë.

Në këtë kohë shterpë,  
as shpirti nuk ka fuqi të reagojë,

kundër kësaj dhimbje të gjatë  
të ngulitur kaq thellë.

A nuk është lajmëtari i vdekjes ai që vjen  
si një hajdut i stërvitur  
duke u shpërfaqur fluturimthi  
me atë hijen e tij të gjatë  
dhe atë lëkurën e tij të thatë  
mbi qiellin e kujtesës time?

Do të hidhesha përpjetë nga gëzimi,  
do ta kujtoja,  
do ta ndjeja,  
nëse shpirti i tij do më përgjigjej  
nëse ai do të më rishfaqej  
qoftë edhe vetem si hije.

Sepse në këto kohë vetmie të madhe  
më mungojnë shumë  
premtimet dhe këshillat që më la.

Mijëra thërmija mendimesh  
vezullojnë dhe papritur zhduken  
në këtë stacion pritje të rremë.

Dhe, nuk është vjeshta  
e as dimri i acartë,  
që brenda mbart  
premtimin e një pranvere të bukur,

që po kërcënon.

Por është një boshësi pafund  
e pa përjetuar kurrë më parë,  
një konfuzion intensiv  
i një jete pa kuptim  
pa energji,  
pa shpresë.

A nuk mjafton që së paku të pyesim;  
A ia vlen në këtë moment  
ruajtja e ca gjërave të vogla, vezulluese,  
të mjaftueshme për të ushqyer veç kuriozët,  
e kohërave që do vijnë?

Dhe a nuk është më e mira gjë  
që mund të presim nga kjo pyetje;  
shpresa se koha mund të ndalojë në këtë vend  
për një çast, për t'i lejuar ndjenjat  
që ato vetë të japin  
një përgjigje miratuese?

Kjo besoj është  
krejt e mjaftueshme  
për të vazhduar të besojmë.  
Krejt e mjaftueshme  
për të vazhduar  
të jetojmë.

## **Me fytyrë nga muri**

Kur zogjtë vdesin  
mishi u tretet,  
e veë kocka e sqepit u mbetet,  
dhe skeleti i kokës  
i fshehur poshtë krahut.

Aty mbesin,  
krejt vetëm, në të ftohtë,  
e duke u lëkundur në erë  
presin ngurtësimin.

Fëmijë të ikur,  
si farë e shpërndarë kuturu,  
shpresë braktisur,  
në këtë kohë të thatë,  
ku dhe lotët janë shterrur,



larg dritës së Zemrës së Shenjtë,  
me kokën kthyer  
me fytyrë nga muri.

Me fytyrë nga muri  
e kokën të varrosur  
në një pellg faji,  
hijet e kujtimeve gjarpërojnë  
përmes rrezeve të diellit  
të kësaj dite të ftohtë dimri.

Me fytyrë nga muri  
e gjetën atë  
plot dy javë më vonë,  
një fqinj i shqetësuar trokiti në derë,  
dhe dorën drejtoi  
drejt atij vendi të vetmuar  
ku të vdekur prisinin  
një zog dhe një njeri  
të dy të ngurtësuar.

Dy qënie të njëjta  
që në vetmi e kishin nxjerrë  
frymën e fundit  
gjatë rrugës së kthimit  
aty ku deti fillon,  
aty ku gjithçka është e qetë  
dhe e pafund.

## **Nokturn 2**

Mola, tani ashtu e dobësuar krejt  
hap krahët me pasion,  
dhe drejt llampës së ndezuar niset,  
ashtu pa u ndjerë  
përmes pluhurit  
me ato lëvizjet e tij të ngadalta.

Krejt e vetmuar  
tenton goditjen e saj të fundit  
para se të vdesë.

## **Pikëllim**

Thellë më kanë pikëlluar ato fjalë të ngrohta  
që u thanë këtu  
për atë, të cilit ia kam mbyllur derën  
në këtë vendbanim të ri.  
Krejt i vetëm,  
në heshjte unë pres,  
fjalët e paftuara të urrejtjes  
të mprehura në gurin e helmit.

Dikur, unë dija fjalë të tjera  
të cilat shndërrisnin  
nga dritë e dashurisë,  
dhe madje, edhe në ëndrra  
si xixëllojna fluturonin  
brenda meje,  
duke më dhënë shumë dritë  
duke më dhënë jetë.

Nganjëherë  
më pushton frika,  
dhe pyes veten  
se nuk do të ketë më kurrë brenda meje  
hapsirë për pikëllimin.

Nëse fjalët e ngrohta  
do kthehen tek unë përsëri  
do ua hap menjëherë  
derën e shpirtit tim.

## **Në shenjë mirënjohje**

Një nga një i kaloj nëpër duar katolinat  
duke kërkuar për diçka më shumë se urimet,  
duke kërkuar ashtu, krejt hutueshëm  
pak dritë në mes të errësirës,  
pa ngushëllimin e fjalëve,  
në një heshtje të thellë që nuk e zgjodha vetë,  
por m'u imponua,  
në këtë orë shterpë  
me emra në njëjes.

Lexoj një mesazh  
të dalë nga zemra e një mikut tim.  
“Poshtë një muri jeton poeti akoma  
dhe Jara këndon për ty.  
Dhe flokët e borës  
në pyllin e errët  
në prijtjen tënde qëndrojnë aty.”

Zemra ime kërcen përpjetë  
në shenjë mirënjohje,  
dhe në sytë e mendjes sërish më shfaqet  
fjala magjike  
“Dashuri”.  
Oh, miku im poet,  
unë të shtërngoj dorën  
pasi e di që gurët mbi të cilët ke shkelur  
janë tejet të sigurtë.

## **Ringjallësit**

Në takim, disa vendosën  
që të mos bëhej seks  
për Ringjalljen,  
veç për lindjen,  
dhe me shikimin e tretur larg.

Të tjerët ishin që të bëhej,  
madje shumë, aq shumë  
sa për të ngritur ushtri të tëra  
të Ringjallurish.  
Në pikën e fundit të rendit të ditës  
pas shumë debatesh e zënkash  
rreth strukturës së fjalive  
dhe ndryshimeve gramatikore  
një zyrtar hijerëndë me syze e kërkoi fjalën.  
“E di që po dal jashtë teme”,  
tha ai krejt i skuqur në fytyrë,  
“por dua të flas për brekët dhe streqet.”

Disa nga të pranishimit u befasuan  
dhe të hutuar panë njëri-tjetrin në sy.  
“Ato duhen bërë prej leshi,” tha ai,  
“deri në momentin që Ringjallja të përfundojë.  
Kjo, që përmes kruarjes, të na rikujtojë ne, atë  
që,  
ne po vuajmë për Ringjalljen”.

Heshjta e akullt u tret menjëherë,  
dhe zhurma e brohoritjeve jehoi  
që nga kati përdhes  
e deri në Rrugën Molesëorth  
ku janë grumbulluar shumë njerëz.  
“Ata janë pro brekëve të leshit,”  
u përhapën pëshpërimat si zjarr i stërmadh,  
“Për Ringjalljen”.

Policët, të cilët, të gjithë i kishin ndryshuar  
emrat,  
mijëra punonjës të administratës  
anëtarë të organizatave shtetërore dhe jo  
shtetërore,  
profesorë dhe klerikë të çuditshëm  
që ishin mbledhur në Rrugën Kildare,  
festuan të gjithë së bashku  
duke vallëzuar.

Duke vallëzuar para godinës së Parlamentit të  
tyre

ata me të drejtë ndjeheshin krenarë.  
Ata po bënëin histori.  
Kombi i tyre i ri ka marrë një vendim  
për Ringjalljen  
dhe ata e ngritën lart mbi supet e tyre  
atë burrin me syze  
i cili e ëndërronte këtë gjë  
dhe madje mori guximin  
dhe e shtroi për miratim  
në pikën e fundit të rendit të ditës;  
gjë që ua mundësoi më pas të gjithëve  
të veshin brekë leshi  
dhe të kruhen  
sa herë të kenë dëshirë  
për Ringjalljen.

## **Lamtumirë zoti Michael**

Një natë në Ammasayanin  
e rrethuar me varre njerzish të shquar  
që ngjanin si gjerdanë guri;  
kryetari i bashkisë  
po shpjegonte me dhimbje  
tek unë, vizitori i tij i dyshimtë,  
se kohët e vjetra kanë vdekur.

Dikur, në ato kohëra  
banorët thernin çdo vit nga një derr,  
dhe kishin mish  
një herë në vit,



kryetari i bashkisë më shpjegonte i përlotur.

Pak më herët, po atë ditë,  
në drekë, Prokurori po përmendte  
krimet kundër Kushtetutës së Turqisë  
që ishin kryer në Detin e Kuq,  
dhe për të cilat ai kërkonte  
dyqind e pesëdhjetë e nëntë dënime me vdekje.

Natën me një çantë në krah,  
në mëngjes duke u shtyrë në radhë  
me vëllezërit kundërshtarë  
për të lyer këpucët,  
Fikriu i vogël tha  
Lamtumirë Michael.

Në televizor  
gjenerali Evren foli gjatë rreth dy episodeve të  
*Dallasit*;  
në hotel unë po paketoja çantën prapë,  
tani për rrugën drejt kthimit në shtëpi.

## **Kalimi i lumit**

Në anën tjetër të lumit  
shoh mikun tim në nevojë.  
Më duhet ta kapërcej lumin.  
Vendos gurë në ujë.  
Ata zhduken, pasi nuk janë të mëdhenj sa duhet.  
Marr gurë më të mëdhenj, i vendos në ujë,  
lodhem e stërmundohem të krijoj një shteg  
drejt bashkimit tonë.

E ndjej thellë izolimin e tij, atje tej, tek po pret.  
Ura e ankthit tim e humb përqëndrimin  
në këtë betejë timen të dështuar  
drejt bashkimit.  
Nuk mund ta imagjinoj dot  
pasionin e pritjes së tij.

I kthehem punës që kam nisur  
dhe vazhdoj fort,  
megjithëse jo fort i sigurtë nëse do ia dal  
vetëm me bindjen e plotë  
që gurët që po vendos  
të mos lëvizin  
dhe të jenë të sigurtë.

## **Një darkë në vetmi në Koh Samet**

*(Per Paddy Leahy)*

Nganjëherë ai ulet vetem  
në tavolinë.  
I vetmuar,  
duke fantazuar dhe ngrënë pilaf,  
aty mes gjithë asaj klientele,  
me plot bukuroshe  
e njerëz me pozitë.

Në mbrëmjet e qeta  
të prag Vitit të Ri  
ky burri i vjetër,  
i vetmuar,  
në atë tymnajë të lagësht të lokalit  
nuk e humb për asnjë çast  
buzëqeshjën e ëmbël  
e as atë vështrimin e tij intim  
mbi fytyrat dhe objektet për rreth.

Netëve vonë  
fëmijët kënaqen pa masë  
duke dëgjuar prindërit dhe detin  
tek tregojnë historitë e tyre.

Këto rrëfime,  
këto fëmijë,  
dhe hëna e plotë në Koh Samet  
i japin një forcë të shumfishtë  
kuptimit të vetë jetës.  
Duke vështruar dallgët se si ikin  
duke i pritur që ato të kthehen sërish  
duke menduar fundin e gjërave  
në pafundësi,  
me vështrimin ngulur mbi këto  
dallgë të larta  
këtu në Koh Samet.

Ai ndjen dhimbje  
për gjërat e shtrenjta që i mungojnë  
dhe momentet e bukura  
të dashurisë së humbur.

Vitet rrëshqasin  
përmes valësh  
dhe kthehen diku, një dallgë larg,  
duke i sjellë atij vetëm një gjë të sigurtë:  
pyetje pa përgjigje,  
pafundësisht shumë,  
aty përmes muzikës së lartë  
dhe të qeshurave të shumta,  
ku nuk nevojiten përgjigjet,  
të paktën në këtë moment,  
këtu nën këtë hënë të plotë në Koh Samet.

## **Varkat e vjetra në Koh Samet**

Ekziston një kopje e shkruar  
e një përkthimi të vjetër  
që burrat në moshën  
kur i kap sëmundja e prostatit  
ia japin njëri-tjetrit për ta lexuar.  
Ata nisin të bëjnë udhëtime turistike  
në vende të mrekullueshme,  
duke provuar të bindin veten se janë  
ende të fortë.  
Ata përpiqen të hipin e të lundrojnë  
plot pasion  
mbi ca barka bambuje prej të cilave  
të qeshurat e moshës së tyre rinore  
si vale deti në formë rrathësh  
u shfaqen në memorjen e tyre të mjegullt.

Duke lundruar  
në ujrat e detit dhe të memorjes  
ata rropaten drejt pleqërisë,  
me tërë atë mbipeshë mishi dhe ndjenjash.  
Kthimin e bëjnë shumë ndadalë.  
Kur mbërrijnë mbrapsht në breg  
ata e ngulin vështrimin në mol  
mbi ca litarë plot nyje të tharë tanimë,  
por që dikur kishin qenë  
mjaf të dobishëm.

## **Varka**

*(Për Daniel)*

Copa drurësh të thyer  
te një varke të vjetër,  
si pa ndjerë,  
ashtu vjedhurazi kanë mbërritur  
në këtë plazh të vetmuar.  
Ato, ashtu tinëzisht  
e kanë bërë këtë hapsirë  
të tyren.  
Kanë sjellë me vete këtu  
momente nga një jetë plot gjallëri  
që kishin patur dikur.  
Këto copa drurësh  
të mbërritura këtu  
sikur bëjnë thirrje  
për t'u kthyer

në funksionet e tyre  
të dikurshme.  
Në to dallohen qartë  
gjurmët plot jetë  
të së shkuarës së tyre.

Me vështrimin mbi këto copa drurësh  
të shpërndarë kuturu  
një fëmijë imagjinon  
ndërtimin e një varke  
në të ardhmen,  
kur atij t'ia lejojnë një gjë të tillë,  
dhe me të, nisë një udhëtim  
për të cilin nuk ekziston  
ndonjë hartë.  
Ai nis të bëjë një mori pyetjesh.  
Ndërsa babai i thotë  
është koha të shkojmë në shtëpi.

Koha e këtyre momenteve të bukura mbaroi.  
I kthejnë shpinën detit,  
hipin në makinë dhe largohen  
ashtu në heshtje,  
babë e bir.

Atje në breg të detit, në rërë  
copat e thyera të drurëve mbetën,  
në pritje të dallgëve të tjera që do të vijnë  
në pritje të një udhëtimi të ri.  
Gjatë natës djali pa në ëndërr

një varkë tek lundronte,  
një varkë tek ngrihej e binte  
mes dallgëve.

Në gjumin e tij të thellë  
në ëndërr ai shkoi sërish  
tek ai plazh i vetmuar,  
dhe u betua se do rikthehet  
për ta provuar prapë  
ndërtimin e asaj varke.

Babai hap derën  
e dhomës ku djali po fle  
dhe ndez dritën.



## **Pol Pot në Anlong Veng**

Pol Pot ka zgjedhur gazetën *Bangkok Post*  
për të thyer heshtjen.

Nga qyteti Anlong Veng në Kambogjia,  
ai nuk kujton, dhe as nuk përmend  
grumbujt e miliona kafkave  
të njerzve të vdekur,  
nuk ka makthe, e naten nuk sheh  
ëndrra të tmerrshme  
me fusha të tëra mbushur me të vrarë,  
pra, asgjë nga këto.

Ai thotë  
se ka mbaruar punë  
me politikën.

Ai është akoma një nacionalist  
i bindur  
dhe ka mjaft vite për të jetuar,

e për të urryer Vietnamin.  
Kur e pyesin  
a ndjen ndonjë pendim  
apo keqardhje,  
ai thote se është shumë i sëmurë.  
Ai deklaroi për gazetën *Bangkok Post*  
se është duke vdekur.

Në kontrast me ata miliona njerëz  
që u vranë për të përmbushur  
një ëndërr të çmendur të këtij përbindëshi  
ai e jep këtë intervistë  
në një ambient mjaft modern  
në rehati e qetësi.

Në faqen e parë të saj  
gazeta *Bangkok Post* thotë se  
monedha Tajlandeze *Baht*  
është zhvlerësuar në mënyrë drastike,  
kjo gazetë gjithashtu  
thotë se Presidenti i Amerikës  
nga baza ushtarake *Airforce One*  
ka deklaruar se ai e dashuron Tajlandën,  
dhe se do ta mbështesë atë në gjithçka.

## **Takim**

Poshtë  
ngjyrës së errët të kësaj moçalishte,  
që ngjan si supë,  
nën këmbët e këtij mali  
krejt të zhveshur,  
qëndron fshehur një dhunë e kahershme  
e bërë kundër natyrës.  
Duket sikur  
brenda mban një tallje  
të heshtur, të butë  
të gjithëpranuar,  
bashkë me lakminë e fshehtë  
e murmuritjet e ca horrave  
të cilët për ca para më shumë  
mund të shisnin dhe babane.

Keni të drejtë të kërkonti gjithçka.

Dhe madje të bëni çfarë të dëshironi me të  
ashtu siç bënë etërit tuaj para jush.

Këto pak metra tokë  
janë krejt ajo ç'ka ju keni.

Kush janë gjithë këta të huaj?  
A nuk kemi jetuar ne këtu për breza të tërë?  
Ai i ka tani.  
Ai mund t'i lërë të ikin.  
Duke rregulluar karrocerinë e makinës,  
me ca degë të holla frashëri  
ishte mënyra më e mirë  
për të transportuar bagatinë,  
ashtu siç baballarët bënë dikur.  
Ai thithi pak naftë me gojë përmes një tubi.

Me atë fytyrën e vrazhdë e të ftohtë,  
ai qeshte me fjalët e tij.  
Fjalët jehonin.  
Ai e dinte se janë fjalë me vend.

S'duam t'ia dimë për ekologjinë  
klithinin dikur ata.

Duke udhëtuar drejt shtëpisë  
ai ishte i sigurtë  
se ai mal dhe ajo moçalishte  
të tijat do të ishin përgjithmonë.

## **Vizita e një të çmendure**

Ai po shikonte ngultazi lulet  
kur mbërriti ajo,  
vizitorja e parë  
pas njëzet vjetësh.

Kaloi përmes një grupi murgeshash  
duke injoruar zhurmën që bënin  
tasat e tyre metalikë,  
zhurmë që ngjante si një simfoni  
e shërbimit të tyre ndaj Zotit,  
tasa me të cilët ata kishin  
hekurosur shamitë që mbanin në kokë,  
dhe sterilizuar mjetet e punës.  
Nga larg  
ata nisën të vështrojnë me lakmi  
bukurinë e asaj vizitoreje;  
e para vizitore e tij  
pas njëzet vjetësh.

“E di historinë tuaj,” i tha ajo  
burrit, i cili kurrë më parë  
nuk kishte patur një vizitor.

“Unë them se është  
një histori shumë prekëse,” shtoi ajo.  
Forca magjike e këtyre fjalëve  
e pushtoi krejt dhomën.  
Ajo ndaloi së foluri  
për pak çaste.  
Por kur nisi të flasë prapë  
ai i dëgjoji sërish ato fjalë.  
Të gjithë i dëgjuan ato fjalë.  
“Më duhet të fluturoj,” tha ajo  
e cila ishte vizitorja e parë aty  
në këto njëzet vjet.  
Ai ia nguli sytë  
me një vështrim aq të çuditshëm  
saqë e trembi fort atë.

“Më duhet të notoj,” tha ai,  
burri, të cilin nuk e kishte vizituar kush  
asnjëherë.  
“Më duhet të notoj,” tha ai,  
“dhe më duhet të iki tani  
atje në pllajën e algave  
ku jeton shpirti i paqtë  
i nënës sime.”

Murgeshat u larguan  
të ndihmuara nga punonjësi i sigurisë.  
Me shamitë e bardha të kokës të hequra  
dhe me buzëqeshje dashamirëse në fytyrë  
ata e tërhoqën mënjanë atë grua,

vizitoren e tij të parë  
pas njëzet vjetësh.

Asaj iu lëngëzuan sytë,  
dhe lotë të kripur filluan  
t'i rrjedhin ndër faqe  
kur dëgjoi zërin e atij burri  
që e pyeste,  
“a nuk është e çmendur një grua  
e cila me një vështrim melankolik  
larg bregut të detit thotë  
më duhet të fluturoj.”

“A nuk ndjen dhimbje  
për ato kujtime të braktisura  
atje pranë detit?  
Eja, eja, noto me mua.  
Le të notojme bashkë.”

Murgeshat e morën burrin mënjanë  
dhe ia arritën të largohen prej aty  
me sukses.  
U kthyen më pas tek jo  
vizitorja e parë e tij  
që prej njëzet vjetësh,  
dhe e pyetën,  
“a dëshiron të të sjellim një çaj?”

### **Nokturn 3**

E falenderoj atë re  
që u largua  
duke na dhënë pak pushim  
nga vranësira dritëzbehtë,  
megjithëse parada të përsëritura  
me tufa resh të tjera që vijnë  
nga askund dhe gjithkund  
zgjatin kthetrat  
duke na kërcënuar.

Kur qielli ndriçohet,  
unë marr frymë  
dhe shpresa sikur më zgjohet.  
Unë kurrë nuk iu kërkoj atyre  
ndonjë garanci për të mos u shfaqur më  
vetëm një largim i përkohshëm  
për pak orë, për pak rreze dielli më shumë  
më mjafton.



## Vinçjeri

Prishja e vinçit ndodh shpesh.  
Nga baza poshtë dhe deri tek krahu i vinçit  
kavoja e trashë lëviz pa pengesa.  
Ai ia ka ngulur sytë asaj dhe i buzëqesh  
ndërkohë që ajo hipur atje lart mbi vinç  
provon dhe një herë me këmbë  
nëse kavoja e vinçit lëviz lirshëm apo jo.

Detyra e tij më e rëndësishme  
është që ajo të mos pësojë ndonjë aksident  
dhe jo që t'i buzëqeshë pareshtur asaj.  
Janë të gjithë punëtorët e pranishëm aty  
ata që presin me padurim buzëqeshjen e saj  
nga atje lart, duke sfiduar rrezikun.  
Kur ndodh që hypin burra atje lart  
për të rregulluar kavon,  
kurrë nuk e shohin me aq vëmendje.  
Shpjegimi i kësaj mosvëmendje  
është fakti që ata e konsiderojnë atë gjë  
një punë të rëndomtë.  
Ajo me një mjeshtri të admirueshme  
rregullon kavon dhe balancon krahun e vincit.  
Atij këtë radhë i mungojne lëvdatat  
nga punëtorët e pranishëm aty.  
Por ata dinë veç gjysmën e kësaj historie.

## **Kupa e kungimit**

Është kupa e kungimit kjo që unë po prek,  
e ngre me të dyja duart,  
dhe me të lëviz gjithandej  
reth e rrotull.

Unë një amator i pastërvitur  
në këtë ceremoni kungimi  
duke e ushtruar këtë profesion  
në heshjte.

## **Zërat në mbrëmje**

Shoqëria e zërave në mbrëmje  
është ushqimi më i ëmbël i shpirtit  
kundër heshtjes së thellë  
të natyrës,  
që lufton me diellin tek rrokulliset  
në humnerat e territ.  
Në pritje të dritës,  
tingujt marramendës të mbrëmjes  
janë si një thirrje e hareshme  
plot humor,  
janë si strehë e përkohëshme  
me një gjysmë çati  
ku banon shpresa  
e njerzimit  
dhe dita e re.

## **Nokturn 4**

Në një hapsirë të rrëmujshme  
në kohëra të ngarkuara plot  
me histori dhe ngjarje,  
është e lehtë të mendosh  
se nuk ka shpëtim,  
dhe teloranca  
nuk nuk lejohet.

Por një copëz dritë  
na rifreskon kujtesën,  
dhe duke sfiduar kohën  
na sjell prespektivë dhe shpresë  
duke na bindur se akoma nuk kemi arritur aty  
ku shpirti fluturon,  
duke injoruar totalisht  
mendimet e lodhura  
dhe dështimin.

Në errësirë  
në fytyrën e të burgosurit  
shndrit një buzëqeshje.  
Një jetë pa vuajtje shfaq konturet e saj,  
nata struket,  
duke i hapur rrugën  
një dite të re  
një dite ndryshe  
që po lind.

## **Kuptimi i Zërave të Shpirtit**

Shpirti bën dritë  
mbi dhimbjen e strukur aty brenda  
duke e flakur jashtë hidhërimin  
përtej kufinjve të Kohës dhe Hapsirës.  
I shpërndarë  
në zbraztinë e dritës  
ai tretet.

## **Të dëbuarit**

Jo, ky nuk është fundi i historisë.  
As nuk janë ezauruar të gjitha idetë  
dhe mundësitë e fundit.  
Është koha e një ideje të vetme,  
gjymtuese, të mbrapshtë dhe vdekjeprurëse,  
që na ngujon dhe ndan ne  
nga bota që kemi imagjinuar.  
Ne akoma nuk ia kemi arritur të krijojmë  
mundësinë e refuzimit  
të shpresës  
për një version më të mirë të vetes tonë.

Në kohën e kësaj intolerance të re  
ne s'mund të flasim për profeci  
ne s'mund të bëjmë kritika  
për zgjedhjet të bëra  
në emrin tonë.

Ka nisur të rikrijohet një mendësi lufte  
Janë shpikur djajtë e ri  
dhe fjalët për t'i përshkruar këto djaj.  
Ka nisur të bëhet seleksionimi  
i atyre që nuk duhen pranuar  
duke mos i konsideruar fare si njerëz.

Kuptimi tradicional i lirisë  
mbi urinë, frikën, abuzimin,

është zbehur krejt  
në këto kohëra të tmerrshme.  
Na thonë ta harrojmë atë premtimin e vjetër  
se bota është krijuar për ne  
dhe ne duhet ta gëzojmë.

Nga thellësitë e shpirtit na del një vajtim.  
Strukemi prej frikës.  
Disa mbyllen në heshjtje.  
Por më pas një dritë rrezaton  
dritë e shpresës  
dritë e një jete më të mirë.

Ne duhet t'i përgjigjemi.  
Sepse kjo do sjellë çlirimin tonë nga terrori.  
Mërgimi ynë do marrë fund,  
jo nga që ne bëmë magjira  
por nga zemrat tona, nga forca,  
besimi dhe përpjekjet tona së bashku,  
duke konfirmuar atë që ne e bëjmë vetë  
historinë tonë  
me forcën e zemrave dhe mendjeve tona.  
Ne e krijojmë fatin tonë vetë,  
së bashku,  
duke ecur përpara dhe rifituar  
atë premtimin e vjetër  
të paplotësuar  
që na ish refuzuar,  
lirinë.

## **Poshtë pemës së një mangoje**

Kur mblidhen poshtë pemës së një mangoje  
Bisedat dhe ëndrrat e tyre janë përreth  
mbijetesës.

Nuk kanë asnjë kujtim të së shkuarës,  
asnjë fitore apo sukses nuk ua trazon ndjenjat,  
madje kujtesa e tyre nuk mbart  
as ndonjë moment humbjeje.



## **Patkoi**

Në gjysmë errësirë  
në mënyrë jo ritmike,  
dëgjohen goditjet dhe shkëndija shpërthejnë  
nga ajo shkrirje e magjishme.

Toka, ajri dhe uji,  
janë bashkë në këtë betejë  
të çëkanit me hekurin  
për t'i dhënë formë  
këtij metali të skuqur  
që mbahet mbi flakë  
derisa mbi të  
të bëhën ca vrima për gozhdat,  
duke krijuar kështu  
një objekt të shndritshëm  
të pazevëndësueshëm

për një tjetër mjeshtër.

Vendoset patkoi,  
thumbat futen në thundra  
me shumë kujdes e mjeshtri,  
më pas ato rrafshohen me limë,  
ndadalë – ngadalë duke i rrafshuar  
thepat anash, ashtu përmes xixave.  
Më pas kali nis rrugëtimin e tij  
duke trokuar pa vështirësi,  
sa që çdokush mund ta quajë  
këtë trok muzikë  
ose thjeshtë shenjë e një pune të mirë  
që ia ka bërë jetën më të lehtë  
kësaj kafshe.

Dhe më në fund, në bare  
nuk ka nevojë më të bëhën  
mrekulli të reja  
me errësirën apo djersën  
për të krijuar gjëra  
të cilat njeriu nuk mund t'i përdorë.  
Kali nis të turfullojë  
krejt i çliruar,  
pa e ndjerë fare rrugën,  
gurët,  
thundrat e tij ndjejnë lirinë e rifituar  
pas gjithë atyre  
rrugëtimeve të mundimshme.

## **Shumë afër tokës**

Shumë afër tokës  
vështronim, poshtë  
nga gryka e pusit tek po shpohej,  
sytë i mbanim tek thundrat e kafshëve  
e nganjëherë i ngrinim gjer tek kurrizi i tyre  
për t'i parë a janë duke ecur në tufë;  
ishte ky si një konkurim i heshtur mes nesh.

Me vështrimin poshtë  
shumë afër tokës  
kur dielli perëndonte  
gjatë atyre stinëve  
që u përkisnin pronarëve,  
duke artikuluar ca thirrje  
të cilat i kuptonin kuajt që tërhiqnin plugun;  
kjo ishte puna e burrave.  
Gratë artikulonin fjalë e tinguj  
që rosat e patat i kuptonin,  
kjo ishte krejt ajo çka ne flisnim.

Asnjëherë nuk e ngrinim vështrimin lart.  
Ndaj diellit ishim krejt indiferent

kur lindte apo kur perëndonte,  
pasi kjo ishte kënaqësi  
që u përkiste të tjerëve.

Fëmijët e fëmijëve tanë  
flasin për peizazhet e mrekullueshme,  
për trupin  
dhe për detin.  
Është tepër vonë për ne.

Me vështrimin poshtë  
shumë afër tokës  
kemi jetuar shumica prej nesh  
dhe na thonin se banorët e Afrikës  
mbas lodhjes e stërmundimit të ditës  
e harronin të nxehtin përvëlues  
dhe në netët e ftohta  
udhërrëfeshin nga ylli i dritës,  
nga ngjyrat lejla dhe e gjelbër  
apo dhe e zeze, si dhe nga copëzat e arit.  
Për ta ngritur vështrimin lart nga dielli,  
zemrat dhe mendjet na duhen.  
Dhe kur ne ia arrijmë, bota gjëmon.  
Në pritjen e saj në këtë prag rilindje  
zëri i saj jehon  
duke na rikujtuar ne  
se jemi vetë ne ato  
që bëjmë të rilindë shpresa jonë  
ato që bëjmë historinë tonë.

## **Krijimi i një stine të re**

Zgjatja,  
përtej kufirit të zakonshëm  
që ishte i pashmangshëm,  
ka qenë gjithmone problem.  
Të të dalë fryma e shpirtit,  
kjo ishte sfida më e madhe  
dhe me pikëpyetjet më të mëdha.

Fëmijë me bark të fryrë,  
gra të nëpërkëmbura,  
manipulim i fakteve shkencore  
në shërbim të luftës,  
më shumë bomba se sa bukë,  
kjo është bërë përditshmëri.  
Një fëmijë i pastrehë  
mësoi prej nënës së tij

prej babait të tij dhe prej një gomari  
se duhej vepruar kështu:  
njërit i duhet të shkojë në Tempull  
dhe të pyesë  
se çfarë mund të jetë pashmangshme.  
Dhe ai kurrë nuk pretendoi  
se ky besim i përkiste vetem atij.  
Kjo pasi se Betlehemi  
ka një histori të madhe,  
dhe fryma e shenjtë na mëson  
se ne do jetojmë një jetë tjetër të re  
ku drita e shpirtit rrezaton  
mbi dhimbjet dhe vdekjen tonë,  
në fatin tonë të përjetshëm,  
dritëplotë,  
duke premtuar lumturinë e pasosur,  
që nuk gjendet në asnjë stinë.  
Mbërritja e saj  
është e pashmangshme.  
Është shpresa jonë  
ajo mundëson një stinë të re  
që i përket një bote tjetër,  
në pritje të ringjalljes sonë.  
Utopi e rikthyer sërish.

## **Fluturimi i Shpirtit**

Shpirti fluturon vetem.  
Nuk ka bashkim duarsh,  
nuk ka vallëzim  
dhe as ndonjë psherëtimë  
për ato që kanë mbetur  
në Tokë.

Asnjë kujtim nga koha  
kur mishi dhe shpirti ishin bashkë,  
në hapsirën e vogël  
të jetës,  
nuk ekziston.

Dhe, a do t'i kërkojë shokët?  
A do t'i thërrasë ato?  
Apo, a do ju përgjigjet atyre?  
Asgjë nuk dihet,  
kjo është e vetmja gjë e sigurtë.

## **Dituria**

Është përcjellja e diturisë ndër breza  
ajo që na ka siguruar mbijetesën.  
Këto njohuri që udhëtuan përmes shqisave  
dhe u pasuan nga brezi në brez  
na çuan drejt një mençurie më të lartë  
e cila me durim qëndroi mes nesh  
derisa ne të ishim gati për të.  
Përtej hartave që ne krijojmë  
dhe përpjekjeve tona  
për të gjetur kordinatat,  
përvojat e mëparshme e bëjnë më të lehtë  
shpikjen e radhës.  
E ajo kur të shfaqet  
nuk do të gjykohet  
bazuar në shkallën e sensacionit  
që shkakton,  
dhe as nga mençuria jonë për ta pranuar.  
Ajo nuk do kthehet në mani  
dhe as nuk do shkaktojë



vrasje ndërgjegje.

Ditura,  
kjo aftësi e shenjtë  
është dëshmi,  
e përsosjes sonë  
të cilës ne i gëzohemi,  
është dëshmi e stërmundimeve tona,  
e rrugëtimit tonë heroik,  
që ofron zgjidhje,  
dhe krijon një jetë më të hareshme.

Misioni ynë nuk është të imitojmë.  
Ne jemi vetë krijuesit  
të lirë ta tregojmë historinë të tërën.

Krijimi dhe e vërteta  
na ngarkojnë ne me misionin  
e zbulimit të gjithçkaje të fshehtë,  
ata kërkojnë që ne të udhëtojmë  
pa komplekse në shtigjet e kujtesës,  
dhe në rrugicat zhgënjyese të imagjinatës,  
besimplotë se në këtë rrugëtim  
nuk jemi vetem.  
Dhe, pa ndjerë aspak frikë  
ta mbushim plot hare këtë udhëtim.  
Kjo është forca jonë,  
triumfuese.

## **Bashkëbisedim**

*(Për Alice Mary)*

Më mirë të bashkëbisedojmë  
se sa të japim këshilla.  
Më mirë të bashkëbisedojmë  
se sa të zihemi.

Vështroj këtë bimë  
që ka nevojë për dritë  
dhe e mallkoj këtë pìrg errësire  
që ka shtrirë kthetrat  
mes dashurisë së vajzës time  
dhe fjalëve të mia.

L ë n d a:

Poeti President i Irlandës.....	5
Pluhur yjor.....	7
Një stinë e thatë.....	9
Në fillim 1.....	13
Në fillim 2.....	15
Në pyll 1.....	18
Në pyll 2.....	21
Kujtesa.....	23
Nëna ime u martua me tim atë në malin Melleray në 1937.....	24
Pusi 1.....	30
Pusi 2.....	31
Gomari.....	32
Hapja e pakove.....	34
Nokturn 1.....	37
Me fytyrë nga muri.....	40
Nokturn 2.....	42
Pikëllim.....	43
Në shenjë mirënjohje.....	44
Ringjallësit.....	45
Lamtumirë zoti Michael.....	48

Kalimi i lumit.....	50
Një darkë në vetmi në Koh Samet.....	51
Varkat e vjetra në Koh Samet.....	53
Varka.....	54
Pol Pot në Anlong Veng.....	57
Takim.....	59
Vizita e një të çmendure.....	61
Nokturn 3.....	64
Vinçjeri.....	65
Kupa e kungimit.....	66
Zërat në mbrëmje.....	67
Nokturn 4.....	68
Kuptimi i Zërave të Shpirtit.....	69
Të dëbuarit.....	70
Poshtë pemës së një mangoje.....	72
Patkoi.....	73
Shumë afër tokës.....	75
Krijimi i një stinë të re.....	77
Fluturimi i Shpirtit.....	79
Dituria.....	80
Bashkëbisedim.....	82

Michael D. Higgins - Poezi - Stinë e thatë

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Michael D. Higgins - Poezi - Stinë e thatë



Tiranë, 2021



